

SKEDA E INFORMACIONEVE PËR QËNDRUESHMËRINË

Riciklimi i materialeve të konsumit

Njësitë e tonerëve

Në vitin 1990, Canon nisi programin e parë global të riciklimit të njësive të tonerëve. Programi ynë i riciklimit të tonerëve i mirënjohur dhe i vlerësuar me çmime vazhdon të rritet dhe tani shtrihet në 18 shtete në Evropë.

Në periudhën mes viteve 1990 dhe 2017, Canon ka mbledhur dhe ka ricikluar më shumë se 394 000 tonë njësi të tilla në botë. Me këtë, ai ka ndihmuar në zvogëlimin me më shumë se 576 000 tonë në emetimet e karbonit CO2. Me rikuperimin, ripërdorimin dhe riciklimin e pjesëve nga kutitë e tonerëve të përdorur, ne e kemi zvogëluar mbështetjen tonë në materialet e reja bazë me më shumë se 273 000 tonë.

Skema jonë e mbledhjes lejon që klientët [t'i kthejnë njësitë e tonerëve të përdorur](#) pa pagesë. Ato dërgohen në impiantin e riciklimit të njësive të tonerëve të Canon që ndodhet në Bretanjë, Francë. Pas çmontimit, disa pjesë ripërdoren në prodhimin e njësive të reja (p.sh. ruli i aktivizimit, fashoja dhe ruli magnetik). Materialet plastike (HIPS) kryesisht nga trupi kryesor i njësisë së tonerit riciklohen në cikël të mbyllur në njësitë e reja. Disa pjesë riciklohen si materiale (p.sh. metali) dhe të gjitha pjesët e tjera rikuperohen si energji.


Kutitë e bojës inkjet

Ne kemi [një program panevropian për kthimin e kutive të bojës inkjet](#) që vepron në 15 shtete. Më shumë se 97% nga çdo kuti riciklohet në produkte të tjera nëpërmjet një partneri të miratuar për riciklimin.

Shishet e tonerëve

Për shishet e tonerëve pa përbërës elektronikë, ne këshillojmë që klienti t'i hedhë ose t'i riciklojë këto produkte si mbetje normale të zyrës në nivel lokal. Në shumicën e rasteve, shishet e tonerëve mund të riciklohen së bashku me plastikën tjetër pasi nuk përmbajnë materiale të rrezikshme dhe ka një ndikim më të vogël mjedisor nga riciklimi lokal.

Shishet e tonerëve me përbërës elektronikë duhet të përpunohen në përputhje me mbeturinat WEEE. Mbeturinat WEEE mund të identifikohen me lehtësi nga simboli i mbeturinave WEEE:



Disa nga organizatat tona kombëtare të shitjeve ofrojnë opsione lokale për mbledhjen dhe riciklimin për shishet/kutië e tonerëve dhe kutitë e bojës së klientëve që përfshihen në kuadrin e direktivës për pajisjet WEEE nëpërmjet palëve të treta. Flisni me përfaqësuesin tuaj lokal të Canon për më shumë informacione.